

AKT NORMATIV
Nr. 2, datë 13.1.2021

**PËR AUTORIZIMIN E AGJENCISË SHTETËRORE PËR SHPRONËSIMIN
PËR NEGOCIIMIN E AFATIT TË SHPRONËSIMIT TË PRONARËVE TË
PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, TË NEVOJSHME PËR
NDËRTIMIN E SPITALIT TË FIERIT**

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Neni 1

Autorizimin e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin që të negociojë dhe të nënshkruajë marrëveshje me pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që do të shpronësohen për ndërtimin e spitalit të Fierit.

Neni 2

Marrëveshja përcakton të drejtën e përdorimit menjëherë të pasurisë së paluajtshme, pronë private, para përfundimit të procedurës së shpronësimit.

Neni 3

Çdo pronar shpronësohet në përputhje me çmimin e përcaktuar në legjislacionin në fuqi.

Neni 4

Nënshkrimi i marrëveshjes së përcaktuar në nenin 1, të këtij akti normativ, nuk pengon pronarët për kundërshtimin në rrugë gjyqësore të çmimit të shpronësimit.

Neni 5

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe